



OLIMPIADA KOMBËTARE E KIMISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 10

Viti shkollor 2023-2024

Udhëzime për nxënësin

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë				
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....


2.....

1. Elementët A dhe D formojnë një përbërje kimike. Numri atomik i elementit A është më i madh se i elementit D . Gjatë formimit të përbërjes, A lëshon 2 elektrone të cilat i merr D . Shuma e numrave atomikë të A dhe D është 20.


- a) Përcaktoni numrat atomikë të elementeve A dhe D . 2 pikë
- b) Paraqit diagramën e shpërndarjes së elektroneve në mbështjellën elektronike (ose formulat elektronike) për atomet e elementeve A dhe D . 2 pikë
- c) Paraqit diagramën e shpërndarjes së elektroneve (apo formulat elektronike) për jonet respektive. 2 pikë
- d) Argumento karakterin e secilit element . 2 pikë
- e) Shkruaj formulën kimike të përbërjes dhe përcakto karakterin e saj (përbërje jonike apo kovalente). 2 pikë

Zgjidhje

- a)
- Meqenëse A e ka numrin atomik më të madh se D dhe shuma është 20 , atëherë A e ka $10 < Z < 20$. Gjatë formimit të joneve , ato synojnë të krijojnë tetëshen elektronike në nivelin e jashtëm energjetik, në këtë mënyrë elementi A nuk mund të ndodhet në periodën e dytë, pra duhet të jetë në periodën e tretë, $Z = 12$ pasi kur i jep 2 elektrone elementit D, do ti mbeten 10 elektrone nga të cilat 8 në nivelin e jashtëm energjetik (A^{2+} : $1s^22s^2p^6$) Elementi D duhet të ketë $Z = 20-12 = 8$. Kur merr 2 e⁻ formon dhe ai tetëshen elektronike në nivelin e jashtëm (D^{2-} : $1s^22s^2p^6$)
- b) A: $1s^22s^2p^6\ 3s^2p^0d^0$, D: $1s^22s^2p^4$ (shpërndarja e elektroneve tek të dy atomet 2,8,2 dhe 2,6)



- c) A^{2+} : $1s^22s^2p^6$, D^{2-} : $1s^22s^2p^6$ (shpërndarja e elektroneve tek të dy jonet 2,8 dhe 2,8)



- d) Elementi A shfaq karakter metalik pasi ka $2e^-$ ne nivelin e jashtëm dhe i lëshon ato, ndërsa elementi D shfaq karakter jometalik pasi ka $6e^-$ në nivelin e jashtëm dhe merr 2 elektrone për të plotësuar tetëshen elektronike.
- e) AD është përbërje jonike pasi formohet nga metal i gr IIA perioda 3 dhe jometal i gr VI A dhe perioda 2.

2.1 a) Një nxënës, në laborator gatiti 5 substanca të reja nga karbonat kalciumi, ujë dhe një llambë me alkool.

a) Shkruani barazimet e reaksioneve kimike që zhvillohen.

5 pikë

2.2 Nga nxehja e 0,5 litra hidrojenkarbonat kalciumi me përqendrim 1M çlironen 9 litra dioksid karboni (në kushte normale).

a) Shkruani barazimin e reaksionit që zhvillohet.


1 pikë

b) Njehsoni përqendrimin molar të tretësirës që mbetet.

4 pikë

($A_{\text{Ca}} = 40$; $A_{\text{C}} = 12$; $A_{\text{O}} = 16$; $A_{\text{H}} = 1$; $V_M = 22,4 \text{ l/mol}$)

Zgjidhje



$$X \text{ mol} \longrightarrow 9 \text{ l} \quad X = 0,4 \text{ mole Ca}(\text{HCO}_3)_2$$

$$n \text{ mbetur} = 0,5 - 0,4 = 0,1 \text{ mol} \quad C_M = n/V = 0,1 \text{ mol} / 0,5 \text{ l} = 0,2 \text{ mol/l}$$

3.1 Jometalet A, E dhe D shfaqin sjelljet e mëposhtme:

- Jometali A zhvendos jometalin E nga tretësira ujore e kripës së tij.
- Jometali D zhvendos te dy jometalet nga tretësirat e kripërave të tyre.

a) Shpjegoni sjelljet e mësipërme.

1 pikë

b) Argumentoni sjelljet e mësipërme duke shkruar tre reaksione kimike.

3 pikë

3.2 Shpjegoni duke dhënë argumente:

a) Në një reaksiون kimik, në cilin rast shuma e masave të reaktantëve është më e madhe se ajo e produkteve, argumento duke shkruar një reaksiون kimik.

2 pikë

b) Si realizohet lidhja kimike ndërmjet atomeve Si dhe O ne oksidin SiO_2 (paraqit skemën e formimit të lidhjeve). ($Z_{\text{Si}} = 14$; $Z_{\text{O}} = 8$)

2 pikë


c) Argumentoni cili nga oksidet e dhënë : Cr_2O_3 , CrO , P_2O_5 shfaq veti amfotere

($Z_{\text{Cr}}=24$, $Z_{\text{P}}=15$)

2 pikë

Zgjidhje


3.1 Kuptohet se sjelljet e mësipërme mbështeten në aftësinë oksiduese të jometalit që gjendet më sipër në grup apo më djathtas e më sipër në tabelën periodike pasi rrezja atomike zvogëlohet dhe vetia oksiduese theksohet. Shembull (metal i gr IA dhe jometal i gr VIIA):



3.2

Nëse zhvillohet një reaksiون në enë të hapur, ku si produkt përftohet një substancë e gazi të e cila largohet atëherë shuma e masave të produkteve do të jetë më e vogël se ajo e reaktantëve.

Shembull: $2 \text{Na} + 2 \text{HCl} \longrightarrow 2 \text{NaCl} + \text{H}_2 \uparrow$



Teorikisht formohen 2 lidhje 2-fishe. Koordinatat për Si janë: perioda 3, grapi IVA. Për t'u lidhur me dy atome oksigjen, silic i nevojiten 4 elektrone të paciftëzuara në nivelin e jashtëm energjistik, të cilën e realizon duke kaluar në gjendje të ngacmuar. Për oksigjenin koordinatat janë: perioda 2, grapi VIA. Kjo tregon se çdo atom oksigjen nga 6 elektronet e nivelit të jashtëm, dy i ka teke dhe i përdor për lidhjet kimike me atomin e silicit.




Figura tregon se një atom silic lidhet me katër atome oksigjen dhe çdo atom oksigjen me dy atome silic. Në natyrë dioksidi i silicit gjendet në formën e kuarcit që është një makromolekulë kovalente (pranohen të dyja përgjigjet).

Kromi: perioda 4, grapi VIB. Cr shfaq valencën II, III, VI. Në oksidet e dhëna Cr shfaq valencën II dhe III, meqenëse valenca III është ajo e ndërmjetmja oksidi Cr_2O_3 ka karakter amfoter ndërsa CrO shfaq karakter bazik. Fosfori: perioda 3, grapi VIA. P shfaq valencën III, V. P_2O_5 shfaq karakter acid.

4.1 Një cope zink (Zn) me masë 4 gram vihet te veproje me 30 ml tretësirë acidi sulfurik me dendësi 1,1g/ml (në kushte normale K.N.). Pas reaksionit, konstatahet se masa e Zn është 3 gram. ($A_{rZn} = 65$; $A_{rS}=32$; $A_{rO}=16$) Njehsoni:

- a) përqindjen e papastërtisë së copës së zinkut . 1 pikë
- b) masën në gram te kripës së përfthuar. 2 pikë
- c) sa atome zink veprojnë me acidin. 1 pikë
- d) sa atome hidrogjen çlironen. 1 pikë
- e) përqendrimin në përqindje te tretësirës se acidit. 1 pikë

4.2 Shpjegoni:

- a) Cila prej tretësirave bazike të mëposhtme ka vlerën e pH më të lartë (tretësirat janë 0.1 M). 2 pikë
- $$KOH_{(uj)} \rightarrow K_{(uj)}^+ + OH_{(uj)}^- , \quad NH_4OH_{(uj)} \rightleftharpoons NH_4_{(uj)}^+ + OH_{(uj)}^-$$
- b) Cila prej tretësirave acide të mëposhtme ka përcjellshmëri më të ulët të rrymës elektrike. 2 pikë
- $$HCl_{(uj)} \rightarrow H_{(uj)}^+ + Cl_{(uj)}^- ; \quad CH_3COOH_{(uj)} \rightleftharpoons H_{(uj)}^+ + CH_3COO_{(uj)}^-$$

Zgjidhje

$$4g - 3g = 1 \text{ g vepron me acidin . } \% = \frac{3}{4} \times 100 = 75\%$$

$$Zn + H_2SO_4 \rightarrow ZnSO_4 + H_2 \quad n Zn = m/M = 1g/65g/mol = 0,015mol$$

$$1mol Zn \rightarrow 1mol ZnSO_4 \quad m_{ZnSO_4} = 0,015mol \times 161g/mol = 2,4g$$

$$1mol \rightarrow 6,02 \times 10^{23} \text{ atome } \Rightarrow d.m.th. \quad 0,015 \text{ mol Zn} \rightarrow 0,0903 \times 10^{23} \text{ atome}$$

$$1mol Zn \rightarrow 1mol H_2 \quad 1mol H_2 \rightarrow 12,04 \times 10^{23} \text{ atome H}$$

$$0,015mol Zn \rightarrow 0,015mol H_2 \Rightarrow 0,015mol \rightarrow 0,1806 \times 10^{23} \text{ atome H}$$


$$1mol Zn \rightarrow 1mol H_2SO_4$$

$$m \text{ tretësirës} = V \times d = 33g \quad 0,015mol Zn \rightarrow 0,015mol H_2SO_4 \quad m_{H_2SO_4} = 1,47g$$

$$C\% = \frac{m_1}{m_2} \times 100 \Rightarrow \frac{1,47}{33} \times 100 = 4,45\%$$



KOH shpërbashkohet plotësisht në jone (elektrolit i fortë). Vlera e pH është më e lartë tek KOH pasi është hidroksid me veti më të forta bazike, ka më shumë jone OH^- në tretësirë. NH_4OH shpërbashkohet pjesërisht në jone (elektrolit i dobët).



Acidi HCl shpërbashkohet plotësisht në jone (elektrolit i fortë) pra përcjell më mirë rrymën pasi ka më shumë jone në tretësirë.

$CH_3COOH_{(uj)} \rightleftharpoons H_{(uj)}^+ + CH_3COO_{(uj)}^-$ Acidi CH_3COOH shpërbashkohet pjesërisht në jone (elektrolit i dobët). Pra në tretësirën e këtij acidi ka më pak jone. Kjo tretësirë ka përcjellshmëri elektrike më të ulët.

5.1 Një kripë e hidratuar përmban elementet në përqindjet respektive:

6 pikë

Na:12,84% , P: 8,66% , H: 7,03% , O: 71,74% . Përqindja në masë e ujit te kristalizimit është 60,35%.

- a) Përcaktoni formulën empirike të përbërjes ($\text{Na}_x\text{H}_y\text{P}_z\text{O}_\beta \times n\text{H}_2\text{O}$).

($A_r\text{Na} = 23$, $A_r\text{P} = 31$, $A_r\text{O} = 16$, $A_r\text{H} = 1$)

5.2 Jepet përbërja X_2O_3 , 0,6 mole te së cilës e kanë masën 118,8 gram dhe ka 108 neurone gjithsej.

- a) Njehsoni numrin e protoneve te elementit X , nëse atomi i oksigjenit ka 8 protone dhe 8 neurone. **3 pikë**

- b) A formon tjetër oksid ky element? Nëse po, shkruani formulën e oksidit dhe përcaktoni karakterin e tij (acid, bazik apo amfoter). **1 pikë**

Zgjidhje

a) $n\text{Na} = 12,84 / 23 = 0,55\text{mol}$; $n\text{P} = 0,28$; $n\text{H} = 6,97$; $n\text{O} = 4,84$, $n\text{H}_2\text{O} = 3,35$

3,35mol H_2O përmban : 6,7 mol H dhe 3,35mol O.

Përbërja përmban: $6,97 - 6,7 = 0,27$ mol H dhe $4,48 - 3,35 = 1,13$ mol O.

Pra në përbërje kemi raportet : $0,55\text{Na} : 0,27\text{H} : 0,28\text{P} : 1,13\text{O} : 3,35\text{H}_2\text{O}$

Duke pjesëtuar me më të voglin e përbashkët marrim numrat e plotë:

2 : 1 : 1 : 4 : 12 formula është $\text{Na}_2\text{HPO}_4 \times 12\text{H}_2\text{O}$

5.2

0,6mol ----> 118,8 gram

$$m\text{O} = nxM = 3\text{mole} \times 16\text{g/mol} = 48\text{g}$$

$$1\text{mol} ----> X\text{gram} \quad X=198\text{g} \quad m(2X) = 198 - 48 = 150 \quad m X = 75 \quad (A=75)$$

$$n^0\text{ O} = 24 \quad n^0\text{ X} = 108 - 24 = 84 / 2 = 42 \quad n\text{rp}^+ = 75 - 42 = 33\text{p}^+$$

Në nivelin e jashtëm energetik elementi X ka 5 elektrone, meqenëse atomi është elektrikisht asnjanës, numri i protoneve (Z) është i njëjtë me numrin e elektroneve në mbështjellën elektronike, pra elementi X gjendet në grupin VA mbështetur në shpërndarjen e elektroneve. Kjo tregon se ai shfaq valencën III dhe V, pra formon dhe oksidin X_2O_5 . Elementi X është jometal i grupit VA, oksidi ka karakter acid.